

**KARTELE INFORMATIVE**

**AL012042**

<b>1. Emri i shërbimit</b>	Ndryshimi i emrit/ mbiemrit në rast papërshtatshmërie			
<b>2. Cili është qëllimi i shërbimit?</b>	Ky shërbim ofrohet për shtetasit që kërkojnë ndryshimin e përbërësit të gjendjes civile (emrit/ mbiemrit) për arsye papërshtatshmërie.			
<b>3. Çfarë ofron ky shërbim?</b>	Pasqyrimi i ndryshimit të miratuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010			
<b>4. A jam përfitues?</b>	Të gjithë shtetasit shqiptarë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC), që kërkojnë ndryshimin e emrit/ mbiemrit si të papërshtatshëm.			
<b>5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?</b>	<b>Nr</b>	<b>Lloji</b>	<b>Dokumenti lëshohet nga:</b>	<b>Dorëzohet në sportel nga aplikanti?</b>
	1	Vërtetimin e gjendjes gjyqësore/ formularin e plotësuar të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore	Ministria e Drejtësisë	Po
	2	Vërtetimin nga prokuroria se nuk është në ndjekje penale	Prokuroria	Po
	3	Vërtetimin nga gjykata se nuk është në proces gjyqësor	Gjykata	Po
	4	Kopjen e letërnjoftimit elektronik (karta e identitetit)	Zyrat e Gjendjes Civile	Po
	5	Vërtetimin se nuk është marrë ndaj tij ndonjë urdhër dëbimi / largimi nga ndonjë shtet tjetër	Ministria e Drejtësisë	Po
6	Vendimin gjyqësor, i njohur sipas legjislacionit shqiptar, në rast të ndryshimit të emrit apo mbiemrit në një vend tjetër, jashtë rasteve të parashikuara nga Kodi i Familjes	Gjykata	Po	
<b>6. Ku mund të aplikoj?</b>	<b>Zyrat pritëse</b>	<b>Qyteti</b>	<b>Adresa</b>	<b>Orari</b>
	Sporteli i ADISA; Zyrat e gjendjes civile në Bashki/ Njësi Administrative	Sporteli i ADISA: në Tiranë, Krujë, Kavajë, Fier, Gjirokastrë dhe Shkodër; Në çdo Zyrë të Gjendjes Civile në Bashki/ Njësi Administrative në Republikën e Shqipërisë	Në të gjitha sportelet dhe qendrat ADISA në Tiranë, Krujë, Kavajë, Fier, Gjirokastrë dhe Shkodër; Në çdo njësi administrative në të cilën qytetari është i regjistruar	ADISA: E hënë- E premte: ora 08:00- 15:00; E hënë - E premte, ora: 08:00 - 16:00
<b>7. A është ky shërbim online?</b>	<b>Niveli 1</b>	<b>Niveli 2</b>	<b>Niveli 3</b>	<b>Niveli 4</b>
	Ofrohet informacion mbi shërbimin	Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Shërbimi ofrohet tërësisht online
<b>8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?</b>	<b>Tarifa bazë</b>	<b>Tarifa shtesë</b>	<b>Tarifa Online</b>	<b>Mënyra e pagesës</b>
	200 lekë për paraqitjen e kërkesës në zyrën e gjendjes civile në bashki/ njësinë administrative 1 000 lekë- procedura e ndryshimit të emrit/mbiemrit 400 lekë- shpallja	Nuk ka		
<b>9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?</b>	Regjistrimi i ndryshimit të emrit/ mbiemrit në Regjistrin Kombëtar, në përfundim të procedurave që zgjasin rreth 240 ditë			
<b>10. Çfarë përfitoj?</b>	Çertifikatë personale për shtetasin të cilit i është miratuar ndryshimi i emrit/ mbiemrit			
<b>11. Ç'afat vlefshmërie ka?</b>	Pa afat			
<b>12. Ku e marr?</b>	Në sportele	Me postë	E-albania	Me e-mail
<b>13. Cili është institucioni përgjegjës?</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC)			
<b>14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?</b>	<b>Kontakto në:</b>		<b>Orari</b>	
	E- albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al DPGJC: www.mb.gov.al/ Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00	

<b>15. Nëse kam ankesë, si të veproj?</b>	Në sportele <input type="checkbox"/>	Me postë <input type="checkbox"/>	Web-i i Institucionit <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input checked="" type="checkbox"/>
	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: <a href="http://www.shqiperiaqeduam.al">www.shqiperiaqeduam.al</a> <input checked="" type="checkbox"/>			
<b>16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?</b>	Ligji Nr. 10 129, datë 11.05.2009, "Për Gjendjen Civile", i ndryshuar Urdhër Nr. 236/1, datë 20.01.2014, " Për Krijimin e komisionit kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit"; Udhëzim Nr. 90, datë 02.04.2014 i Ministrit të Punëve të Brendshme, "Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së shpalljes, për kërkesën e ndryshimit të emrit /mbiemrit" Udhëzim Nr. 91, datë 02.04.2014 i Ministrit të Punëve të Brendshme, "Për rregullat lidhur me përcaktueshmërinë e emrave / mbiemrave të konsideruar të papërshtatshëm dhe të atyre me rëndësi historike, të familjeve të shquara në shkallë kombëtare, apo të mirënjohura në bashkinë/ komunën, ku ka vendbanimin personi i interesuar"; Urdhër i përbashkët Nr. 146 , datë 19. 05. 2015 i Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Ministrit të Financave, "Për caktimin e tarifave për paraqitjen e kërkesës dhe afishimin e shpalljes së kërkesës për ndryshimin e emrit/ mbiemrit"			